



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 31.05.2023

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 31.05.2023, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 561, të datës 19.05.2023, paraqitur nga Kryetari i Komunës, të shqyrtuar në mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (s), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (n), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 4, paragrafi 4, nën paragrafi 4.1, nenin 5, të Rregullores për përmbajtjen e simboleve komunale dhe kushteve për ndarjen e titujve të nderit, çmimeve, mirënjohjeve dhe shpërblimeve tjera Nr. 83, të datës 06.06.2016 mori:

V E N D I M

**Për shpalljen e shkrimtarit dhe publicistit z. Ismail Kadare “Qytetar nderi” i
Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2023**

1. Për shpalljen e shkrimtarit dhe publicistit z. Ismail Kadare “Qytetar nderi” i Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2023, është i lindur me datën 28.01.1936, në qytetin e Gjirokastrës, shkollën fillore dhe të mesme e kreu në vendlindje Degën e Gjuhës dhe Letërsisë, në Universitetin e Tiranës në vitin 1958 dhe studimet për Letërsinë Botërore “Maksim Gorki”, në Moskë 1958-1960, është shkrimtar i letërsisë shqipe dhe një ndër shkrimtarët e njohur të letërsisë botërore, autor i shumë veprave letrare, shumë këngëve, publicist i njohur i adresimit të çështjeve me rëndësi shoqërore dhe kombëtare të popullit tonë me ndikim në formimin e brezave.
2. Veprat më të njohura të shkrimtarit nga fusha e letërsisë janë të shumta ndër to janë: Frymëzimet djaloshare, Ëndërrimet, Shekulli im, Gjenerali i Ushtrisë së Vdekur, Kështjella, Kronikë në gurë, Qyteti pa reklama, Prilli i thyer, Kush e solli Doruntinën, si dhe shumë vepra të tjera, është fitues i shumë titujve dekoratave, çmimeve letrare kombëtare dhe ndërkombëtare, delegat në Kongresin e Drejtëshkrimit.
3. Z. Ismail Kadare për titullin e dhënë nga Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës, mban të drejtat dhe privilegjet që i takojnë titullit “Qytetar nderi” sipas akteve ligjore dhe nënligjore.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Shkrimtarit, Drejtorisë së KRS dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOŠOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 01.06.2023

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 31.05.2023, ka shqyrtuar Rekomandimin e Komitetit për Politikë e Financa me Nr. 129, të datës 31.05.2023, në lidhje me paragrafin një të vendimit Nr. 15, të datës 03.02.2023, i aprovuar sipas Propozimit me Nr. 48, të datës 18.01.2023, të paraqitur nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 8 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049, (Gazeta Zyrtare Nr. 27/2008), nenin 27 të Ligjit 03/L-048, për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (ç) dhe nenin 54 të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 15, të datës 03.02.2023 lidhur me lejimin e bartjes së mjeteve financiare të pa shpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit fiskal 2022 në vitin fiskal 2023

1. Për ndryshimin-plotësimin e vendimit Nr. 15, të datës 03.02.2023, për paragrafin një të lejimit të bartjes së mjeteve financiare të pa shpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit fiskal 2022, në vitin fiskal 2023, sipas Rekomandimit Nr. 129, të datës 31.05.2023 nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, që ndërlidhet me hapjen e kodit të ri në investime kapitale të emërtimi i projektit për 'Blerjen e pronës në lagjen 028 dhe 029 në lagjet e banuara nga komunitetet joshumicë në Komunën e Fushë-Kosovës', e prezantuar edhe në formën tabelare - pjesë e vendimit Nr. 15, të datës 03.02.2023, fshihet tërësisht nga paragrafi një i vendimit dhe pjesa tabelare e vendimit për bartjen e buxhetit të pa shpenzuar për vitin 2022.
2. Ndryshim - plotësimi i vendimit Nr. 15, të datës 03.02.2023, është në paragrafin një të vendimit dhe pjesën tabelare të bartjes së buxhetit të pa shpenzuar për vitin fiskal 2022, në vitin fiskal 2023, me emërtimin e ri të projektit kapital për investime publike dhe hapjen e kodit të projektit për 'Ndërtimin e fushës së sportit në lagjen 028 dhe 029 të banuara nga komunitetet jo shumicë në Komunën e Fushë-Kosovës'.
3. Shpërndarja e të gjitha mjeteve tjera financiare të bartura sipas përshkrimit bazik në vendimin Nr. 15, të datës 03.02.2023 dhe pjesa tabelare e përshkrimit të kategorive ekonomike, kodeve të programeve dhe kodeve të projekteve tjera publike, mbesin të pa ndryshuara për secilin shpenzim në dokumentin financiar që është pjesë e këtij vendimi.

4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë për Financa dhe Buxhet.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.hh

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorive tjera të Komunës dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
Drejtoria e Administratës - DIRECTION OF ADMINISTRATION

Relat/Ref: 131
Data/Date: 07.06.2023

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 07.06.2023

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 31.05.2023, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 556, të datës 18.05.2023, i shqyrtuar në mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa dhe komitetit për Komunitete, bazuar nenit 124, paragrafi 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës - organizimi dhe funksionimi i vetëqeverisjes lokale, nenin 2, paragrafi 2.1, i Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal - lidhur me të drejtën e komunës për rregullimin dhe menaxhimin e burimeve të veta financiare, (Gazeta Zyrtare Nr. 27/2008), nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (ç) dhe nenin 54 të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për realizimin e zhbllokimit të mjeteve financiare të grumbulluara nga të hyrat vetanake të Komunës së Fushë-Kosovës për shpenzim në vitin 2023

1. Për zhbllokimin e mjeteve financiare të grumbulluara nga të hyrat vetanake të Komunës së Fushë-Kosovës në vitet 2021 dhe 2022, për shpenzim në vitin 2023, nga niveli qendror - Qeveria e Republikës së Kosovës, respektivisht Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve, sipas specifikimit të mjeteve financiare të vitit 2021 dhe 2022, në Propozimin e Kryetarit të Komunës me Nr. 556, të datës 18.05.2023, është si në vijim:
 - 1.1 Shuma e përgjithshme e mjeteve financiare të grumbulluara nga të hyrat vetanake për vitet 2021 dhe 2022 është prej: 6,354,114.03€, prej këtyre mjeteve financiare të kontraktuara për shpenzime nga vitet e kaluara në vitin 2023, është shuma prej: 1.625.537.98€, e shpërndarë dhe zbërthyer në vitet përkatëse;
 - 1.1.1 Shuma e ndarë e mjeteve financiare për vitin 2021, është në shumë prej: 3,287,802.98€, ndërsa prej këtyre mjeteve financiare të kontraktuara për shpenzime, është shuma prej: 923,517.28€;
 - 1.1.2 Shuma e ndarë e mjeteve financiare për vitin 2022, është në shumë prej: 3,066,311.05€, ndërsa prej këtyre mjeteve financiare të kontraktuara për shpenzime, është shuma prej: 702,020.70€;
 2. Mjetet financiare sipas pikës një të këtij vendimi janë të hyra vetanake të komunës dhe duhet të alokohen për shpenzime, tek komuna që e ka bërë grumbullimin e tyre, sipas nenit 124, paragrafi 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës - organizimi dhe funksionimi i vetëqeverisjes lokale, ku komunat kanë të drejtë të vendosin, të caktojnë, të mbledhin dhe

të shpenzojnë të hyrat e veta, si dhe të marrin fonde nga Qeveria qendrore, në pajtim me ligjin.

3. Pavarësinë financiare të komunës, e definojnë edhe neni 2, paragrafi 2.1, i Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, ku komuna ka të drejtë të rregullon dhe menaxhon burimet e veta financiare të cilat rrjedhin nga të hyrat vetanake komunale, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.
4. Bllokimi i të hyrave vetanake të komunës deri në muajin qershor 2023, është i pa pranueshëm, antikushtetues dhe antiligjor, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisë, Ligjit mbi Ndarjet Buxhetore për vitin 2023 dhe Statutin e Komunës, andaj përmes këtij vendimi, ne kërkojmë veprime dhe vendime konkrete për zhblokimin e këtyre mjeteve financiare, në mënyrë që komuna të kryen obligimet e veta financiare, që rrjedhin nga kontratat me operatorë ekonomike dhe realizim të projekteve tjera publike.
5. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë për Financa dhe Buxhet.
6. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.hh

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorive tjera të Komunës dhe Arkivës.


Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 07.06.2023

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.05.2023, pas rishqyrtimit të kërkesës së Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, lidhur me vendimin Nr. 110, të datës 05.05.2023, sipas shkresës me Nr. 2551-3/23, të datës 24.05.2023, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2 shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 53, të Ligjit për Procedurën Administrative Nr. 05/L-031, (Gazeta Zyrtare Nr. 19/2016), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për shfuqizimin e Vendimit Nr. 110, të datës 05.05.2023 dhe Planit të Veprimit Nr. 111, të datës 05.05.2023, për miratimin e Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2023-2027

1. Për shfuqizimin e vendimit Nr. 110, të datës 05.05.2023 dhe Planit Lokal të Veprimit Nr. 111, të datës 05.05.2023, për miratimin e Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2023-2027, sipas shkresës së Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës me Nr. 2551-3/23, të datës 24.05.2023, lidhur me aprovimin e Propozimit Nr. 258, të datës 17.03.2023, për shqyrtimin e dytë të Projekt-Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit për marrjen e vendimit për miratimin e këtij plani.
2. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së SHPM dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Ali Ismaili



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKTORIJA ZA ADMINISTRACIJU

W/Idag/Or.sh. 133
Datë/Datum. 07-06-2023
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 07.06.2023

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.05.2023, pas rishqyrtimit të kërkesës së Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës sipas shkresës me Nr. 2552-3/23, të datës 24.05.2023, lidhur me vendimin Nr. 112, të datës 05.05.2023 dhe Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave Nr. 113, të datës 05.05.2023, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (ç) nenin 40, paragrafi 40.2 shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 8, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3, nenin 10, paragrafi 2, paragrafi 5, të Ligjit për Mbeturina Nr. 04/L-060 (Gazeta Zyrtare Nr. 17/2012), nenin 6, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 08/L-071 për ndryshim - plotësimin e Ligjit për Mbeturina Nr. 04/L-060, (Gazeta Zyrtare Nr. 29/2022), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për rishqyrtimin e Vendimit Nr. 112, të datës 05.05.2023, për miratimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave Nr. 113, të datës 05.05.2023, për territorin e Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2023-2027

1. Për rishqyrtimin dhe përmirësimin e vendimit Nr. 112, të datës 05.05.2023, për miratimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2023-2027 dhe Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave Nr. 113, të datës 05.05.2023, sipas shkresës së Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës me Nr. 2552-3/23, të datës 24.05.2023, në bazën e tij ligjore.
2. Përmirësimi i vendimit bëhet në bazën e tij ligjore, sipas specifikimit të kërkuar nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, lidhur me vendimin Nr. 112, të datës 05.05.2023, sipas shkresës me Nr. 2552-3/23, të datës 24.05.2023, lidhur me përshkrimin e bazës ligjore, të Ligjit për Mbeturina Nr. 04/L-060 dhe Ligjit Nr. 08/L-071 për ndryshim - plotësimin e Ligjit për Mbeturina Nr. 04/L-060.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së SHPM dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 07.06.2023

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.05.2023, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 467, të datës 12.05.2023, të paraqitur për shqyrtim nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, të shqyrtuar në mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (ç) nenin 40, paragrafi 40.2 shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), në Strategjinë për Migrim 2021-2025, e miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 22/2020, për rintegrimin e personave të riatdhesuar dhe Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës për integrimin e të huajve Nr. 09/2019, nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për miratimin e Planit Komunal për rintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Fushë-Kosovës për vitet 2023-2025

1. Me aprovimin e këtij vendimi Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, bazuar në Strategjinë për Migrim 2021-2025, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr. 22/2020 për rintegrimin e personave të riatdhesuar, Rregulloren për integrimin e të huajve Nr. 09/2019, miratohet 'Plani Komunal për Rintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të huajve në Komunën e Fushë-Kosovës për vitet 2023-2025'.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është 'Plani Komunal për Rintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të huajve në Komunën e Fushë-Kosovës për vitet 2023-2025'.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera, për zbatimin e këtij vendimit dhe 'Planit Komunal për Rintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të huajve në Komunën e Fushë-Kosovës për vitet 2023-2025', është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili

